


REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPALITY OF GILAN / GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

**V E N D I M**

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 500 (pesëqind euro) për Imri Jakupin për trajtimin e sëmundjes së Diabebes mellitus tip 2 E11 (Glikemia e qasit).
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Mjetet derdhen në xhirologarinë e Imri Jakupit me [REDACTED]
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfutjesit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.


**Vendimi i dorëzohet**

- Palëve,
- DSHMS, dhe
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës**  
**Alban Hyseni**



**KOMUNA E GJILANIT**  
**OPŠTINA GNJILANE**  
**MUNICIPALITY OF GJILAN**  
**GILAN BELEDIYESI**



**MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM**

**ndërmjet**

**Komunës së Gjilanit, si autoritet publik**

**dhe**

**Imri Jakupi, përfitues**

**Gjilan, 2023**

**Neni 1**  
**Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për Luftë Malin nga Gjilani, për shërimin e sëmundjes së Diabetez melitus tip 2 E 11 (Glikemia e qasiti), sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 22 paragrafi 1.8)

**Neni 2**  
**Vlera e Subvencionimit**

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 500 € (pesëqind euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilani për përfutjesin.

**Neni 3**  
**Obligimet e palëve**

1. **Obligimet e përfutjesve të subvencionit janë :**
  - 1.1. mjeket e marra, përfutjesit do t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllimet e paraqitura në Kërkesë.
  - 1.2. përfutjesit duhet të raportojnë tek Komuna e Gjilani brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfutjesit duhet të sjellin tek Komuna e Gjilani:
  - 2.1. raportin narrativ (shtojçë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjeket e shpenzuara (shtojçë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje).
  - 2.2. njofton Komunën e Gjilani për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit.

**Neni 4**  
**Obligimet e Komunës së Gjilani janë:**

- 1.1. obligohet që shumën nga paragrafi 1 i neni 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhircologarinë bankare të përfutjesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
  - 1.2. bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilani mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

**Neni 5**  
**Afartet kohore**

1. Afartet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.

2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6

**Shkëputja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

- 1.1. tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
- 1.2. marrëveshjes me shkrimin nga të dyja palët në marrëveshje;
- 1.3. shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë parashikuar me këtë marrëveshje dhe
- 1.4. mos realizimit të subvencioneve për shkakë objektive.

Neni 7

**Kthimi i mjeteve**

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të parapartë me projekt, përfutjesit janë të obliguar t'i kthejnë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9

**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 10

Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.



**Komuna e Gjilanit**

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**

  
**Imri Jakupi**